

Vendim nr. 162 datë 12.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 12.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 36 (A) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ARDIAN AVDOLLI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 41-2023-465 (72), datë 15.02.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 15, pika 2, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka regjistruar procedimin penal nr. 321, viti 2021, në ngarkim të të dy të pandehurve, vëllezër mes tyre, të akuzuar për veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 89 e 25 të

Kodit Penal (KP). Ky procedim është bazuar mbi një konflikt të ndodhur në datën 25.04.2021, në ambientet e qendrës së votimit, fshati Vashtëmi, Korçë, në të cilin ka mbetur i dëmtuar kërkuesi Ardian Avdolli dhe dy familjarët e tij (babai dhe bashkëshortja).

2. Në përfundim të hetimeve, prokuroria i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për miratimin e urdhrit penal, datë 16.07.2021, për deklarimin fajtorë të të pandehurve sipas akuzës dhe caktimin e dënimit ndaj tyre gjorbë në vlerën 80,000 lekë dhe 60,000 lekë. Gjykata, me vendimin nr. 41-2021-2671 (349), datë 30.07.2021, ka vendosur refuzimin e miratimit të urdhrit dhe kthimin e akteve prokurorit, me arsyetimin se çështja nuk mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet e hetimeve paraprake, bashkëlidhur kërkesës për miratim.

3. Në vijim, prokuroria ka paraqitur në gjykatë kërkesën për dërgimin e çështjes penale për gjyq. Në datën 25.01.2023, gjykata, me vendimin e ndërmjetëm ka pranuar kërkesën e të pandehurve për gjykimin e shkurtuar.

4. Më tej, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2023-465 (72), datë 15.02.2023, ka deklaruar fajtorë të pandehurit sipas akuzës dhe, në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i ka dënuar përfundimisht me 60,000 lekë dhe 50,000 lekë gjorbë. Gjykata ka arsyetuar se ata kanë konsumuar plotësisht elementet e veprës penale, të parashikuar nga nenet 89 dhe 25 të KP-së, ndërsa nuk e gjen të bazuar pretendimin e kërkuetit - në cilësinë e viktimës në këtë proces, se nga ana e të pandehurve është konsumuar vepra penale “Pengimi i zgjedhësit”, të parashikuar nga neni 330, pika 2, i KP-së, pasi nuk konstatohet asnjë element i kësaj veprë penale, edhe pse konflikti ka ndodhur në ambientet e qendrës së votimit dhe si shkak i lindjes së konfliktit ka qenë mënyra e votimit të disa prej votuesve. Në pikën 4 të dispozivit të vendimit, gjykata është shprehur se kundër këtij vendimi mund të bëjnë ankim prokurori dhe të pandehurit. Ndërkohë, nuk rezulton që ndonjë prej palëve në procesin penal të ketë paraqitur ankim dhe në datën 07.06.2023, sekretaria e gjykatës ka vendosur shënimin se vendimi ka marrë formë të prerë në datën 24.05.2023.

5. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual të regjistruar në datën 12.06.2023, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit 41-2023-465 (72), datë 15.02.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuetit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

- 6.1. *E drejta e procesit të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspekt të:
- 6.1.1. *Parimit të barazisë së armëve*, pasi gjykata ka dhënë në një vendim të bazuar në një akuzë të pasaktë, nuk ka marrë parasysh kërkesën për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe për kryerjen e veprimeve hetimore shtesë, duke qenë se shkak i ngjarjes ka qenë procesi i votimit dhe jo ekzistenca e konflikteve të vjetra familjare. Sipas tij, ajo nuk ka përcaktuar saktë se çfarë cilësie/funksioni ka pasur një nga të pandehurit në procesin e votimit, por ka pranuar akuzën e ngritur nga prokurori, megjithëse ishte e pabazuar në ligj dhe në prova.
- 6.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi gjykata nuk ka dhënë asnjë arsye, qoftë edhe formale, për rrëzimin e kërkesave të tij dhe as pse akuza është e qenësishme dhe e bazuar në prova e ligj, si dhe as përse hetimi është i plotë dhe i gjithanshëm.
- 6.1.3. *Sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi dy trupa gjyqësore të së njëjtës gjykatë, përkatësisht në vendimet nr. 41-2021-2671 (349), datë 30.07.2021 dhe nr. 41-2023-465 (72), datë 15.02.2023, kanë mbajtur qëndrime diametralisht të ndryshme në lidhje me të njëjtën çështje.
- 6.2. *Dinjiteti i njeriut*, i garantuar nga paragrafi 4 i Preambulës dhe neni 3 i Kushtetutës, pasi një nga të pandehurit në cilësinë e një funksionari, gjatë procesit zgjedhor për shkak të detyrës ka ushtruar dhunë ndaj katër zgjedhësve. Me këto veprime ai ka cenuar jo vetëm integritetin fizik, por edhe dinjitetin njerëzor të një familjeje të tërë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

8. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së

kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Kushtetuta në nenin 42 parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa proces të rregullt ligjor (*pika 1*). Ndërsa, sipas nenit 45 të saj, çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet (*pika 1*) dhe kjo e drejtë është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë (*pika 2*).

10. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se vepra penale e kryer nga të akuzuarit duhej të ishte cilësuar për njërin prej tyre, i cili kishte edhe funksione publike në procesin e votimit (vëzhgues), “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Pengimi i zgjedhësit”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 330, paragrafi 2, të KP-së, ndërsa për të akuzuarin tjetër “Pengimi i zgjedhësit”, të parashikuar nga neni 330, paragrafi 2, i KP-së. Kjo, pasi ngjarja ka ndodhur jo si pasojë të konflikteve të vjetra familjare, por si pasojë e procesit të votimit dhe veprimet e të pandehurit kanë penguar nënën e tij të votojë. Konkretisht, sipas kërkuetit, njëri nga të pandehurit, në cilësinë e vëzhguesit në qendrën e votimit, ka penguar familjarët e tij për të ndihmuar nënën, e cila për shkak të moshës dhe të gjendjes shëndetësore ka pasur vështirësi për të votuar. Për shkak të kësaj, ata janë konfliktuar në grup dhe kërkuesi së bashku me familjarë të tjerë të tij ka pësuar dëmtime fizike.

11. Kolegji, fillimisht, evidenton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2023-465 (72), datë 15.02.2023, në ushtrim të rolit të saj kushtetues për vlerësimin e fakteve dhe rrethanave, si dhe interpretimin dhe zbatimin e ligjit, u ka dhënë përgjigje pretendimeve në themel të kërkuetit, kur ka arsyetuar se në rastin konkret nuk konstatohet asnjë element i veprës penale “Pengimi i zgjedhësit”, të parashikuar nga neni 330, pika 2, i KP-së, në veprimet e kryera nga të akuzuarit. Nga ana tjetër, Kolegji, referuar përcaktimeve kushtetuese për ushtrimin e së drejtës së votës dhe përmbajtjes së pretendimeve të kërkuetit, vëren se thelbi i tyre lidhet me një mosmarrëveshje, shkaku i së cilës ka qenë pengimi i ushtrimit të kësaj të drejte, nënës së tij. Duke qenë se kërkuesi pretendon se e drejta e votës i është cenuar nënës së tij, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual drejtuar Gjykatës duhet të ishte paraqitur prej saj, në kushtet kur ajo ka pësuar cenim të drejtpërdrejtë dhe vetjak të së drejtës kushtetuese të pretenduar.

12. Për rrjedhojë, kërkuesi, nuk legjitimohet *ratione personae* për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, pasi nuk mund të mbrojë një të drejtë kushtetuese të një personi tjetër edhe pse ka lidhje të afërt familjare me të. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

13. Si përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.